



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Tiranë, më 12.07.2024

NJOFTIM PËR SHTYP

Kontrolli i Lartë i Shtetit është njohur me lajmin për ndalimin e një punonjësi të shërbimeve mbështetëse nga organet e rendit.

Në lidhje me këtë lajm Kontrolli i Lartë i Shtetit sqaron opinionin publik se, shtetasi Rezart Maqellara ka qenë i punësuar në Kontrollin e Lartë e Shtetit me detyrën e “punonjësit të shërbimeve” në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse.

Shtetasi i mësipërm është punësuar në KLSH në përputhje me përcaktimet e Kodit të Punës dhe kriterëve përkatëse të emërimit, duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar si vërtetim nga Prokuroria dhe Gjykata etj., përfshirë dhe eksperiencën e mëparshme të punësimit si Efektiv i Gardës së Republikës.

Kontrolli i Lartë i Shtetit sapo është njohur me njoftimin për ndalimin e shtetasit të sipërpërmendur ka bërë zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës.

Vlerësojmë punën e institucioneve ligjzbatuese për garantimin e rendit dhe sigurisë publike si dhe inkurajojmë goditjen e çdo paligjshmërie.

Kontrolli i Lartë i Shtetit

Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë

E-mail: klsh@klsh.org.al

Tel: +355 4 2247294 / +355 4 2251267